



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 3830 Prot.

Fier më 25.03.2026

Projekt - Vendim

Nr. 32 Dt. 25. 03.2026

“Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike” në pronat e Bashkisë Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____ .03.2026, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave, bazuar në kërkesat zyrtare nr. 10567 prot. dt. 17.09.2025, nr. 12958 prot. datë 13.11.2025, nr. 899 prot. dt. 23.01.2026 dhe nr. 3678 prot. dt. 19.03.2026 të shoqërisë “Power Energy” sh.p.k, me lëndë “Kërkesë për lejim dhe kalimin e linjës kablllore 35 kV rreth 2.4 km të gjatë që lidh këtë impiant me zbarat 35 kV në Nënstacionin 220/35/20 kV (Sunny Side Energy) dhe bashkëpunim për ndërhyrje në infrastrukturën e kullimit në funksion të ndërtimit të parkut fotovoltaik “Power Energy” sh.p.k., shoqëri e cila me V.K.M nr. 310 dt. 04.06.2025 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncensionit, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë Njësia Administrative Dërmënas, Bashkia Fier Qarku Fier, nga shoqëria “Power Energy” sh.p.k.”, ka marrë miratimin për Ndërtimin e Centralit Gjenerues të Energjisë Elektrike Fotovoltaike dhe Veprave Ndihmëse, i cili nuk është objekt koncensionit dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë Njësia Administrative Dërmënas, Bashkia Fier si dhe ka lidhur kontratën nr. 5129 rep. nr. 2337 kol. dt. 13.06.2025 me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me anë të të cilës i është dhënë e drejta e financimit, projektimit, ndërtimit, pronësisë, vënies në punë, operimit, shfrytëzimit, administrimit dhe mirëmbajtjes të Centralit Fotovoltaik, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të kontratës me vendndodhje në zk. 3038 fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmënas, Bashkia Fier Qarku Fier.

Bazuar bazuar në nenin 9, pika 1.2, nenin 54, shkronja “e, e/1” të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", (të ndryshuar), Ligjin Nr. 8744, date 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtëshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", ligji nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit", VKM Nr. 854, datë 04.12.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dermënas, të Qarkut Fier", VKM 510 dt. 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial", ,

VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministira e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të Personelit dhe të Aseteve të luajtshme e të Paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 109 dt. 27.11.2025 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, Ligji nr. 68 datë 27.04.2017, “Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, « Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë» (i ndryshuar), Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë «Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit», **Kryetari i Bashkisë:**

Propozon:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për dhënie të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore të transmetimit të energjisë elektrike” në pasuritë nr. 415 (rrugë), 203 (kanal), 215 (rrugë) zk. 1451, pasuritë nr. 156 (rrugë/kanal), 10/30 (rrugë), 157 (rrugë/kanal), 50/29 (rrugë), 158 (rrugë/kanal), 11/32 (rrugë), 163 (rrugë/kanal) 49/8 (rrugë) në ZK 3038, prona të Bashkisë Fier.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Fier për nënshkrimin e akt marrëveshjes dhe çdo dokument të nevojshëm në dobi të qëllimit të saj.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave
Drejtor: M. Petushi

Drejtoria Juridike
Drejtor: E. Kapllanaj

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit
Drejtor: E. Kola

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejtor: P. Çina

KRYETARI

Armando SUBASHI

